

**Tiranë, më 9.4.2025**

### **Njoftim për shtyp**

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK), z. Altin Dumani, në ushtrim të kompetencës së Komisionerit Publik, ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku nisi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 521, datë 1.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Erjon Shehaj, me funksion prokuror/drejtues në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, në mënyrë unanime, vendosi:

*Ndryshimin e vendimit nr. 521, datë 1.4.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Erjon Shehaj.*

*Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.*

*U shpall sot, në Tiranë, më datë 9.4.2025*

Ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të SPAK-ut, në rubrikën “Procesi i rivlerësimit”:  
<https://spak.gov.al/>

Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, referuar nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ushtron kompetencat e Komisionerëve Publikë, që prej datës 1.1.2025.